

Rregullat e Eco-Higjiena Sh.p.k. për Trajtimin e të Dhënave Personale

1. Qëllimi dhe Parimet Themelore

Eco-Higjiena Sh.p.k., me seli në Gjilan, është e përkushtuar për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve, klientëve, punonjësve dhe partnerëve të saj.

Ne përpunojmë të dhënat personale në përputhje me **Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** dhe **Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)** të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i këtyre rregullave është të garantojnë transparencë, siguri dhe përputhje të plotë me standardet ligjore gjatë përpunimit të çdo të dhëne personale.

2. Çfarë të dhënash përpunojmë?

Përmes faqeve tona “Kontakti” dhe “Karriera”, mbledhim të dhëna personale që jepen vullnetarisht nga përdoruesit. Këto përfshijnë:

a) Përmes faqes “Kontakti”:

- Emri dhe mbiemri
- Numri i telefonit
- Email adresa
- Subjekti dhe mesazhi

b) Përmes faqes “Karriera”:

- Pozita për të cilën aplikohet
 - Emri dhe mbiemri
 - Email adresa
 - Numri i telefonit
 - Dosja CV (e ngarkuar nga aplikanti)
 - Përgjigjja në pyetjen: “Pse dëshironi të bëheni pjesë e ekipit tonë?”
-

3. Burimet e të Dhënave

Të dhënat mbledhen në mënyrë të ligjshme nga burimet e mëposhtme:

- Drejtpërdrejt nga vetë klienti gjatë regjistrimit ose lidhjes së kontratës;
- Nga përfaqësuesit e autorizuar të klientit;
- Nga institucionet publike, në rastet kur parashikohet me ligj;

- Nga burime publike, vetëm kur është e lejueshme me legjislacionin në fuqi.
-

4. Qasja dhe Përpunimi i Të Dhënave

Qasja në të dhënat personale kufizohet vetëm për personat e autorizuar nga Eco-Higjiena, të cilët i përdorin ato ekskluzivisht për qëllime pune.

Të dhënat nuk ndahen me palë të treta, përveç rasteve kur:

- Kërkohe me ligj nga institucionet shtetërore përkatëse;
- Është e nevojshme për përmbushjen e kontratës së klientit;
- Është dhënë pëlqimi paraprak i personit përkatës.

Çdo qasje apo përpunim i paautorizuar ndalohet rreptësisht dhe sanksionohet sipas ligjit.

5. Ruajtja dhe Siguria e Të Dhënave

Të dhënat personale ruhen në mënyrë të sigurt në sistemet tona digjitale dhe fizike, duke respektuar standardet më të larta të sigurisë.

Masat e sigurisë përfshijnë:

- Ruajtje të enkriptuar të të dhënave elektronike;
- Qasje të kufizuar përmes fjalëkalimeve dhe autorizimeve të kontrolluara;
- Ruajtje fizike të dokumenteve në ambiente të sigurta;
- Trajnim të vazhdueshëm të stafit për mbrojtjen e të dhënave.

Të dhënat ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur.

Pas përfundimit të qëllimit, ato fshihen ose anonimizohen në mënyrë të sigurt.

6. Të Drejtat e Personave përkatës

Çdo person që ka dhënë të dhënat e tij personale ka të drejtë të kërkojë:

- **Qasje** në të dhënat e tij personale;
- **Korrigjimin** ose **përditësimin** e të dhënave të pasakta;
- **Fshirjen** e të dhënave, në rast se ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur;
- **Kufizimin e përpunimit**, në rast dyshimi për shkelje;
- **Kundërshtimin** e përpunimit për qëllime specifike.

Kërkesat mund të bëhen me shkrim në adresën zyrtare të kompanisë ose përmes emailit.

7. Ankesat dhe Kontakti për Privatësinë

Nëse mendoni se të dhënat tuaja janë përpunuar në mënyrë të paligjshme, mund të paraqisni ankesë pranë:

Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP)

ose drejtpërdrejt te zyrtari ynë për mbrojtjen e të dhënave personale në kontaktet e mëposhtme:

Përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

Eco-Higjiena Sh.p.k.

Rr. “Vjosa”, Nr. 62, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës

Tel: +383 (0)45 71 70 77

E-mail: office@ecohigjiena.com

8. Transparenca dhe Përditësimet

Ky dokument është publik dhe i disponueshëm:

- Në webfaqen zyrtare të Eco-Higjiena: www.ecohigjiena.com
- Në selinë qendrore të kompanisë në Gjilan
- Në pikat e shërbimit në Viti dhe Kamenicë

Çdo ndryshim në këto rregulla do të publikohet menjëherë në faqen zyrtare dhe do të hyjë në fuqi pas publikimit.

9. Deklaratë e Përgjithshme

Eco-Higjiena Sh.p.k. angazhohet të mbrojë privatësinë dhe të dhënat personale të çdo qytetari dhe klienti.

Ne trajtojmë çdo informacion me kujdes, ndershmëri dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, duke garantuar standardet më të larta të sigurisë dhe transparencës.

10. Shënim për transferimin e të dhënave jashtë vendit

Në kuadër të mirëmbajtjes së sistemeve tona digjitale, **Eco-Higjiena Sh.p.k.** mund të përdorë shërbime nga kompani që veprojnë jashtë Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në disa raste, këto kompani mund të mos ofrojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje të të dhënave personale siç parashikohet nga **Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregullorja GDPR**.

Eco-Higjiena ndërmerr masa të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë:

- Zgjedhjen e partnerëve të besueshëm dhe të certifikuar,
- Kufizimin e përpunimit vetëm për qëllime operative,
- Marrëveshje për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurisë.

11. Përdorimi i cookies dhe teknologjive të tjera

11.1 Cookies

Faqja jonë përdor cookies për funksionim bazë, për të analizuar trafikun dhe për të përmirësuar përvojën tuaj të përdorimit. Kur vizitoni faqen tonë, një baner do t'ju informojë për përdorimin e cookies dhe do të mund të zgjidhni nëse dëshironi t'i pranoni ato.

11.2 Google Analytics

Përdorim Google Analytics dhe Site Kit by Google për të mbledhur të dhëna statistikore të anonimizuar për mënyrën se si përdoruesit ndërveprojnë me faqen tonë, si:

- Adresën IP
- Pajisjen dhe sistemin operativ
- Kohën e qëndrimit në faqe
- Faqet e vizituara

3.3 Google reCAPTCHA V3

Formulari “Karriera” është i mbrojtur me Google reCAPTCHA V3 për të parandaluar abuzimet. Ky sistem mund të mbledhë të dhëna teknike për të vlerësuar nëse përdoruesi është njeri apo robot, si: IP, lëvizjet e mausit, etj. Këto të dhëna përpunohen sipas Politikës së Privatësisë dhe Kushtet e Shërbimit të Google.

12. Përdorimi i shtojcave (plugins)

Faqja përdor disa shtojca teknike dhe funksionale për përmirësim të përvojës së përdoruesit. Vetëm ato që përpunojnë të dhëna personale janë përmendur në këtë politikë. Plugin-at që nuk ndikojnë në të dhënat personale (si për përkthim, dizajn ose SEO) nuk listohen specifikisht.

13. Ndryshime në këtë politikë

Kjo politikë mund të përditësohet herë pas here për të reflektuar ndryshime në legjislacion ose në mënyrën se si operon faqja jonë. Çdo ndryshim do të publikohet në këtë faqe dhe do të hyjë në fuqi menjëherë pas publikimit.